

Projekti i strehimores për personat LGBTQI+ në Kosovë



Hulumtuese: Blinera Jashanica & Samira Dulaj
Mentore: Prof. Ass. Dr. Njomza Llullaku

Nëntor, 2025

QENDRA PËR BARAZI DHE LIRI TË KOMUNITETEVE LGBT NË KOSOVË (CEL)

HULUMTUESE: BLINERA JASHANICA & SAMIRA DULAJ

MENTORE: PROF. ASS. DR. NJOMZA LLULLAKU

COPYRIGHT © CENTRE FOR EQUALITY AND LIBERTY TË GJITHA TË DREJTAT E REZERVUARA. ASNJË PJESË E KËTIJ PUBLIKIMI NUK MUND TË RIPRODHOHET, TË RUHET OSE TË TRANSMETOHET NË ÇFARËDO FORME ELEKTRONIKE, MEKANIKE FOTOKOPJUESE, INCIZUESE APO NDRYSHE, PA LEJEN PARAPRAKE TË CEL KOSOVA.

Klauzolë e përgjegjësisë

Ky publikim u financua nga Ambasada e Holandës në Kosovë, Ambasada e Dukatit të Madh të Luksemburgut dhe Global Fund for Women, dhe është bashkëpunim me Universitetin e Prishtinës. Përmbatja e publikimit është përgjegjësi e vetme e CEL Kosova dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pikëpamjet e partnerëve dhe donatorëve.

Abstrakti

Ky punim kishte për qëllim të të hulumtojë mbi nevojat e personave LGBTQI+ për krijimin e strehimores, të elaboroj iniciativën e projektit për themelimin e strehës, mbështetjen institucionale, rëndësinë dhe ndikimin e strehës në jetën e personave LGBTQI+. Përmes metodologjisë kualitative me intervistën si instrument, u realizuan 8 intervista (n=8), ku tre nga to ishin me përfaqësues të organizatave/aktivistë (n=3) ndërsa pesë ishin me persona LGBTQI+ (n=5). Të gjeturat tregojnë se për shkak të situatave të dhunës dhe përjashtimit, ndërtimi i strehimores është e domosdoshme për sigurimin e mbrojtjes sociale dhe ofrimit të shërbimeve të nevojshme. Poashtu, të gjeturat tregojnë se projekti i strehës është ende në proces dhe se aktualisht Kosova ka dy njësi baneesore nga Komuna e Prishtinës që të mbulojnë përkohësisht nevojat. Poashtu, ideja e strehimores përvec sigurisë fizike është konceptuar si projekt holistik që ofron shërbime psiko-sociale dhe programe profesionale në mënyrë që të fuqizohen personat LGBTQI+.

Hyrje

Personat që vien nga minoritetet seksuale dhe gjinore kanë më shumë gjasa të përjetojnë të qenurit të pastrehë për shkak të përjashtimeve nga familja, shoqëria, pjesëmarrja më e ulët në treg të punës apo problemeve tjera që vien si pasojë e stigmës (Wilson, Choi, et al., 2020; Badgett et al., 2019). Mungesa e strehimores së sigurtë është një nga faktorët e rrezikut që personat LGBTQI+ (sidomos të rinjët) të përfshihen në sjellje si abuzimi me substanca dhe krijimi i varësisë (Saewyc et al., 2017; Kattari, Barman-Adhikari, DeChants, & Rice, 2017), sjellje tjera të rrezikshme (Bauermeister, Eaton, Meanley, Pingel, & UHIP Partnership, 2017; Ecker, 2016; Gattis, 2013) apo dhe përjetimi i dhunës fizike (Saewyc et al., 2017). Përveç këtyre, sfidat në shëndetin mendor që vijnë si pasojë e mos-strehimit të sigurtë është një nga sfidat tjera që përjetojnë personat LGBTQI+, ku studimet tregojnë se personat raportojnë nivele të larta të depresionit, stresit post-traumatik, ideve dhe tentimeve për vetëvrasje (Gattis & Larson, 2017; Gattis, 2013; Moskowitz et al., 2012). Studimet kanë gjetur se personat (pavarësisht orientimit seksual apo identitetit gjinor) të cilët përjetojnë të qenurit të pastrehë janë në rrezik më të shtuar për tu ballafaquar me sfida të shëndetit fizik dhe mendor (Bender et al., 2015; Edidin et al., 2012).

Duke pasur parasysh se hapësirat specifike mund të jenë të rrezikshme apo stimuluese në aspekt negativ, studiuesit kanë përcaktuar mënyrat/karakteristikat e hapësirave të sigurta të cilat duhet të plotësohen (Maton, 2008; Harper & Schneider, 2003). Case and Hunter (2012) kanë karakterizuar këto hapësira si mjedise ku personat e marginalizuar mund t'i sfidojnë status-quot e narrativit në raport me identitetin e tyre si dhe hapësirat që nuk lejojnë që këto narrative të jenë pjesë e mjedisit aktual. Të tilla këto janë konceptuar psh. qendrat "drop-in" apo strehimoret (Thompson et al., 2010). Hapësirat e tilla lejojnë personave që të përforcojnë mekanizmat e reziliencës dhe ballafaqimit në mënyrë që të përmissohet mirëqenia psiko-sociale, të njejtat arrihen nëse mbrenda tyre ka praktika të shërbimeve që kanë fokus krijimin e besimit dhe ofrimin e mbështetjes së pakushtëzuar (Case & Hunter, 2012; Slesnick et al., 2008). Në raport me strehimoret, studimet tregojnë se strehimoret e përgjithshme të cilat nuk përceptohen si miqësore ndaj personave LGBTQI+ ndikojnë që personat mos të ndjehen të sigurtë dhe si rrjedhojë mos të kërkojnë fare shërbim (Alessi et al., 2020). Raporti i organizatës The Trevor Project tregon se për të ofruar strehimore të sigurta ka disa kushte të cilat duhet të plotësohen dhe ndër to është ofrimi i trajnimeve të stafit për kompetencën në raport me çështjet LGBTQI+, bashkëpunim më i madh mes strehimoreve dhe shërbimeve të kujdesit psikologjik apo ofrim i këtyre shërbimeve brenda vetë strehimoreve si dhe të ketë modalitete të strehimoreve që ofrojnë hapësira neutrale gjinore. Studimet tregojnë që mjediset e përbashkëta të modelit klasik të strehimoreve nuk janë të përputhshme për shumë nga identitetet e personave LGBTQI+ (Maccio & Ferguson 2016), poashtu duke qenë që kornizat ligjore apo shërbimet ekzistuese strehuese të vendeve munden mos të akomodojnë dy gjinitë, shumë aktivistë avokojnë për strehimore të posaqme për personat LGBTQI+ të cilat ofrojnë shërbime gjithëpërfshirëse si privatësi, siguri, shërbime psikologjike, ligjore dhe staf të trajnuar për të punuar veçanërisht në këtë institucion.

Në kontekstin e Kosovës personat LGBTQI+ përballen me sfida të ndryshme (CEL, 2022; CSGD, 2023). Në raport me çështjen e strehimit, Kosova në vitin 2020 ka bërë një hap historik në ndarjen e një buxheti prej 300.000-euro për ndërtimin e strehimores që i dedikohet personave LGBTQI+ (Indeksonline, 2020). Por, deri tani ky projekt ende nuk është realizuar (BallkanInsight, 2024). Aktualisht, për personat që përjashtohen nga shtëpia apo përjetojnë dhunë dhe kanë nevojë për strehim, këto raste drejtohen në strehimoret e përgjithshme për viktimat e dhunës (USAID, 2023) por këto strehojnë vetëm vajzat dhe gratë. Ndërsa, të tjerët, në rastet kur ka hapësirë, dergohen për strehim në strehimoren në Tiranë e cila është e dedikuar për personat LGBTQI+, por organizatat e shoqërisë civile CEL dhe CSGD avokojnë për hapjen e strehimores në Kosovë duke argumentuar se shumë persona detyrohen të ikin jashtë vendit (Dylberizëm, 2024; Telegrafi, 2024). Aktualisht, Komuna e Prishtinës ka ndarë dy njësi banesore të cilat do të shërbejnë si hapësira të përkohshme deri në ndërtimin dhe funksionalizimin e strehimores së përhershme (CSGD, 2025).

Duke pasur parasysh gjetjet e studimeve ndërkombëtare lidhur me rëndësinë dhe urgjencën e krijimit të strehimores dedikuar për personat LGBTQI+ me shërbimet adekuate të inkuorporuara, ky punim ka për qëllim të hulumtojë mbi nevojat e personave LGBTQI+ për krijimin e strehimores, elaboroj iniciativën e projektit për themelimin e strehës, mbështetjen institucionale, rëndësinë dhe ndikimin e strehimores në jetën e personave LGBTQI+.

Metodologjia

Ky hulumtim ka përdorur metodat kualitative me intervistën si instrument, duke qenë që intervista na ndihmon në marrjen e të dhënave të thella rreth eksperiencave, bindjeve dhe qëndrimeve (Hammarberg, Kirkman, & Laces, 2016). Protokoli i hulumtimit ka përfshirë gjithsej 15 pyetje dhe katër kategori tematike si: nevoja për strehimore, iniciativa e projektit për themelimin e strehimores, mbështetja institucionale, rëndësia dhe ndikimi i strehimores në jetën e personave LGBTQI+. Në këtë studim është përdorur mostra e qëllimshme (purposeful sampling) me kritere të përcaktuara (criterion sampling) për shkak të natyrës së temës sepse kjo lloj mostre na mundëson përzgjedhjen e rasteve të cilët janë të përfshirë direkt ose të kenë njohuri mbi temën që studiohet (Palinkas et al., 2015). Kjo mostër është përdorur me përfaqësuesit e organizatave/aktivistë ku në total, janë kryer tre intervista me përfaqësues të organizatave/aktivistë (n=3). Ndërsa, për personat LGBTQI+ ka pasur 5 pyetje bazë me kategoritë tematike mbi a) nevojën e strehimores, b) përgjegjësinë institucionale dhe c) ndikimin e strehimores në jetën e personave LGBTQI+, këtu është përdorur mostra e rastësishme me intervistat me pesë persona LGBTQI+ (n=5) në hapësirën e “Bubble Bar” për të siguruar përfaqësim të ndryshëm dhe për të marrë perspektiva të ndryshme mbrenda grupit.

2.1 PROCEDURA

Para se të fillojmë me mbledhjen e të dhënave në terren është bërë shqyrtimi i literaturës mbi temën duke analizuar studime ndërkombëtare, artikuj lokalë lidhur me temën. Pyetjet e intervistave për të dy palët (me disa ndryshime) janë formuar mbi disa kategoritë kryesore tematike si nevoja për strehimore, iniciativa e projektit për themelimin e strehimores, mbështetja institucionale, rëndësia dhe ndikimi i strehimores në jetën e personave LGBTQI+, ku për intervistat me personat LGBTQI+ nuk janë fokusuar pyetjet tek iniciativa e projektit dhe mbështetja institucionale.

Tek pjesa e intervistave me përfaqësues të organizatave/aktivistë, nga hulumtueset dhe mentorja janë kontaktuar përfaqësues të cilët kanë qenë të përfshirë në iniciativën e projektit të strehimores dhe intervistat janë bërë në formë fizike (n=2) dhe online (n=1). Ndërsa, tek pjesa e intervistave me personat LGBTQI+, hulumtueset kanë vizituar kafenenë/hapësirën “Bubble” dhe nga aty kanë zgjedhur në mënyrë të rastësishme pjesëmarrësit (n=5). Të gjitha pjesëmarrëset në hulumtim janë informuar për qëllimin e hulumtimit, konfidencialitetin dhe u është treguar që mund të ndalim regjistrimin e intervistës nëse nuk ndjehen rehat. Intervistat janë regjistruar me audio në disa raste (n=2), në njërin rast përgjigjet e pyetjeve janë dorëzuar me shkrim (n=1) dhe të tjerat janë transkriptuar gjatë kohës së intervistave (n=5). Pas përfundimit të mbledhjes së të dhënave, është filluar me analizimin e të dhënave (kodimin, kategorizimin, interpretimin). Të njëjtat janë rishikuar, rikoduar nga mentorja e temës për të siguruar validitetin dhe besueshmërinë e analizës.

2.2 INTERVISTAT

Intervistat kanë qenë gjysmë të strukturuar me total 15 pyetje bazë të katër kategorive tematike. Pyetjet e intervistave kanë ardhur nga analizimi dhe shqyrtimi i literaturës dhe analiza e kontekstit të Kosovës në raport me tematikën. Pyetjet janë formuluar nën udhëzimin e mentores. Pjesëmarrësve përfaqësues të organizatave ju është kërkuar të flasin mbi: a) nevojën e strehimores, b) iniciativën e projektit, c) mbështetjen institucionale dhe d) ndikimin e strehimores në jetën e personave LGBTQI+. Ndërsa, intervistat me pjesëmarrësit persona LGBTQI+ kanë pasur 5 pyetje bazë dhe ju është kërkuar të flasin mbi a) nevojën e strehimores, b) përgjegjësinë institucionale dhe c) ndikimin e strehimores në jetën e personave LGBTQI+. Intervista e gjysmë-strukturuar kanë zgjatur afër 30 minuta me përfaqësuesit e organizatave dhe 20 minuta me personat LGBTQI+.

3. REZULTATET

Ky hulumtim ka intervistuar dy grupe, përfaqësuesit e organizatave/aktivistë që punojnë në çështjet LGBTQI+si dhe vetë personat LGBTQI+. Protokoli i hulumtimit për grupin e parë (përfaqësuesit e organizatave/aktivistë) ka përfshirë gjithsej 15 pyetje dhe katër kategori tematike si: nevoja për strehimore, iniciativa e projektit për themelimin e strehimores, mbështetja institucionale, rëndësia dhe ndikimi i strehimores në jetën e personave LGBTQI+. Ndërsa për personat LGBTQI+, ka pasur kategoritë tematike si: nevoja për strehimore, përgjegjësia institucionale dhe ndikimi i strehimores në jetën e personave LGBTQI+.

Intervistat me përfaqësuesit e organizatave

KATEGORIA TEMATIKE: NEVOJA PËR STREHIMORE

Gjetjet nga intervistat në raport me kategorinë e nevojës për strehimore tregojnë se ekziston një nevojë urgjente për krijimin e strehimores dedikuar personave LGBTQI+ në Kosovë, kjo vie si pasojë se shumë persona LGBTQI+ përjashtohen nga familjet e tyre dhe mbesin pa asnjë mbështetje, përveç përjashtimit, të intervistuarit potencojnë se këta persona, në disa raste përjetojnë forma të ndryshme të dhunës mbrenda mjediseve familjare. Jetesa në kontekst heteronormativ dhe me sistem jo mjaft të qëndrueshëm në raport me ofrimin e shërbimeve/mbrojtjen sociale për personat LGBTQI+, konteksti si ai i Kosovës bën që këta persona të jetojnë në fshehtësi apo në rastet kur dalin hapur, në mungesë të pavarësisë ekonomike dhe mbështetjes institucionale mbesin pa strehim.

“Nevoja për krijimin e një strehimoreje buron nga rrethanat e rënda me të cilat përballen personat LGBTQI+ në Kosovë, sidomos përjashtimi nga familja dhe dhuna në ambiente familjare. Këto situata i lënë shumë individë pa mbështetje, pa siguri dhe pa mundësi për t’u strehuar në mënyrë të sigurt. Për këtë arsye, strehimorja është parë si një domosdoshmëri dhe prioritet që nga fillimi i punës së organizatës sonë” – P 002.

Duke qenë që në Kosovë aktualisht nuk ekziston asnjë strehimore për personat LGBTQI+, pavarësisht se komuniteti konsiderohet si një ndër grupet më të rrezikuara për përjashtim, praktika e deritanishme ka qenë që rastet të dërgohen në strehimoren në Shqipëri por të intervistuarit tregojnë se kjo është një zgjidhje alternative por se kufizimet e strehimores ku vetëm një person nga Kosova mund të strehohet aty si dhe specifikat lidhur me dokumentacionin, çështjet administrative burokratike, ndërrimin e rrethit shoqëror, periudhën e qëndrimit për vetëm 6 muaj etj e bëjnë këtë zgjidhje jo të qëndrueshme. Pas përfundimit të kohës së qëndrimit, personat detyrohen të kthehen në të njëjtat rrethana prej nga kanë ikur. Organizatat tregojnë se kanë pasur numër të konsiderueshëm të personave që kanë pasur nevojë për strehim emergjent, por poashtu për shërbime shoqëruese si mbështetje psikologjike, ndihmë ligjore apo orientim/këshillim profesional në mënyrë që të fuqizohen dhe rindërtojnë jetën e tyre. Poashtu, potencohet se nga mungesa e strehimores, shumë persona LGBTQI+ janë strehuar tek miqtë duke u treguar kështu një solidaritet mes komunitetit në mungesë të shërbimeve.

“Në të kaluarën ka ekzistuar bashkëpunim me strehimoren në Shqipëri, e cila vazhdon të funksionojë, mirëpo kapaciteti i saj është shumë i kufizuar, vetëm një person nga Kosova mund të strehohet aty. Ndërkohë, rastet që kanë nevojë për strehim në Kosovë janë shumë më të shumta. Edhe pse bashkëpunimi me Shqipërinë ekziston, ai shpesh është i vështirë për shkak të procedurave ligjore dhe dokumentacionit, pasi kërkohet leje qëndrimi në një shtet tjetër. Kjo e bën të domosdoshme ndërtimin e një strehimoreje brenda Kosovës, në mënyrë që personat që përjetojnë dhunë të mos detyrohen të largohen nga vendi dhe të shkojnë në një ambient të panjohur” – P 001.

Prandaj, nga intervistat del se ndërtimi i një strehimoreje vie nga nevoja se personat LGBTQI+ për shkak të mos pranimit social shpesh herë mund të përballen me situata dhune e përjashtimi mbrenda sistemit familjar, ku strehimorja shihet si shërbim i domosdoshëm për sigurimin e mbrojtjes së mënjëhershme dhe ofrimin e hapësirës së sigurt të plotësuar me gjithë shërbimet tjera të nevojshme që i mundësojnë personave pavarësi dhe mirëqenie më të shëndetshme.

KATEGORIA TEMATIKE: INICIATIVA E PROJEKTIT PËR THEMELIMIN E STREHËS

Të gjeturat nga intervistat tregojnë se ideja për themelimin e strehimores dedikuar personave LGBTQI+ ka lindur pothuajse që nga viti 2013 sepse organizatat gjithmonë e kanë pasur prioritet krijimin e strehimores por sidomos nga viti 2020 u avokua më fuqishëm pasi që organizatat kishin raste të shpeshta që kërkonin strehim, ku kjo situatë u bë shumë më e dukshme gjatë pandemisë. Poashtu, një nga të intervistuarët thekson se për shkak të mungesës së strehimores personat LGBTQI+ mund të bien pre e situatave të rrezikshme vetëm sa për të siguruar elementet bazike të strehimit.

“Ideja ka lindur si rezultat i përvojës së drejtpërdrejtë me raste të dhunës dhe përjashtimit nga familjet. Që nga themelimi, në vitin 2013, organizata jonë ka pasur prioritet krijimin e një strehimoreje që do t’u ofrojë siguri dhe mbështetje personave LGBTQI+, duke e trajtuar këtë çështje si një nga pikat kryesore të avokimit tonë publik dhe institucional” – P 002.

Të intervistuarit theksojnë se procesi ka filluar përmes avokimit me Komunen e Prishtinës ku është hartuar plani i projektit, identifikimi i lokacionit dhe mundësitë e licensimit. Pavarësisht se gjithë kjo ishte filluar pesë vite më parë, aktualisht ende nuk ka strehimore për shkak të vonesave administrative dhe pengesave teknike ku tani projekti është në fazën e përcaktimit të lokacionit mirëpo organizatat janë në pritje të ndarjes së buxhetit për të filluar ndërtimin e funksionalizimin e strehimores. Gjithashtu theksohet se në vitin kur veçse ka filluar diskutimi mbi strehimoren, komuna e Prishtinës e ka pasur në buxhet plan strehimoren mirëpo më vonë është hequr. Nga shyrtimi i literaturës, kemi gjetur se në korrik të vitit 2021, komuna ka ndarë dy banesa që do të shërbejnë përkohësisht si strehimore e sigurt për personat LGBTQI+ të cilët përballen me situata të dhunës dhe përjashtimit.

Sa i përket strukturës dhe idesë se si do funksiononte strehimorja, të gjeturat tregojnë se strehimorja nuk është konceptuar asnjëherë në sensin vetëm të strehës por si hapësirë që ndihmon në mbështetjen dhe fuqizimin e rasteve përtej ofrimit të strehimit. Rrjedhimisht, ideja e strehimores është në ofrimin e shërbimeve holistike si shërbime psiko-sociale, ndihmë ligjore, trajnime për punësim dhe zhvillim profesional si dhe programe për fuqizim.

“Streha nuk është vetëm një dhomë duhet të jetë e strukturuar me kujdes, sepse personat që shkojnë aty kanë përvoja traumatike. Duhet të ketë shërbime shëndetësore, psikologjike dhe sociale; punëtori social dhe psikologu duhet të jenë të pranishëm. Nuk mjafton vetëm profili profesional duhet edhe trajnim që i ndihmon të jenë më të ndërgjegjshëm ndaj rasteve dhe të kontribuojnë në fuqizimin e personave. Përveç shërbimeve... streha duhet të shihet si vend i sigurt, ku personat LGBTQI+ e ndjejnë që jeta e tyre po merr formë tjetër” – P 003.

KATEGORIA TEMATIKE: MBËSHTETJA INSTITUCIONALE

Të gjeturat tregojnë se bashkëpunimi ndërinstitutional është qenësor për realizimin e projektit të strehimores, të intervistuarit përmendin institucionet si Ministria e Drejtësisë, Policia e Kosovës, Prokuroria, Gjyqësori dhe Ministria e Shëndetësisë si faktorë kyç që duhet të ndërveprojnë mes vete për të kordinuar hapat e licensimit, sigurimit të mbrojtjes sociale dhe ofrimin e shërbimeve në kuadër të strehimores.

Të intervistuarit shprehin se sfidat kryesore në raport me institucionet kanë qenë në aspekt administrativ dhe burokratik, ku duke marur parasysh gadishmërinë fillestare të komunës së Prishtinës, besohet se këto sfida nuk reflektojnë kundërshtime ndaj idesë por më shumë neglizhim në konsiderim të idesë si prioritet institucional.

“Sfidat kryesore kanë qenë të natyrës burokratike dhe administrative – si vonesat në caktimin e lokacionit, pengesat për licencim dhe mungesa e vendimmarrjes konkrete për ndarjen e fondeve. Këto sfida nuk lidhen domosdoshmërisht me kundërshtime ndaj projektit, por me mungesën e prioritetit institucional” – P 002.

Poashtu, theksohet se deri tani bashkëpunimi ka qenë me komunën e Prishtinës dhe me organizatat ndërkombëtare por ky bashkëpunim ka qenë më shumë konsultativ ndërsa për aspekt të mbështetjes financiare kjo mbetet ende e paplotësuar. Kjo përkrahje e shtetit dhe trajtim i projektit jo vetëm si iniciativë e OJQ-ve por si politikë shtetërore për sigurimin e mbrojtjes për personat e marginalizuar përmendet si qenësore për suksesin e këtij projekti pasi që vetëm nëse ekziston një qasje dhe komunikimin konstruktiv ndërinstitutional mund të sigurohet që projekti i strehimores ka plotësuar gjithë fazat e licensimit, buxhetimit, funksionalizimit të qëndrueshëm.

Kategoria tematike: Rëndësia dhe ndikimi i strehës në jetën e personave LGBTQI+.

Rëndësia dhe ndikimi i strehimores në jetën e personave LGBTQI+ është në disa forma, fillimisht përmendet se përmes ofrimit të një hapësire të sigurt do inkurajohej që personat të cilët ballafaqohen vazhdimisht me dhunë dhe me situata të pakëndshme të dinamikave të pashëndetshme, të raportojnë rastet dhe të mund të marrin shërbimin e nevojshëm. Përveç aspektit të sigurisë fizike, theksohet se strehimorja do ndihmonte në fuqizimin e personave LGBTQI+ dhe do ndihmonte në adresimin e nevojave psiko-sociale përmes ofrimit të shërbimeve profesionale. Si dhe, funksionalizimi i strehimores do tregonte një qëndrim të shtetit pro vlerave të barazisë, respektimit të të drejtave të njeriut, respektimit të dinjitetit etj.

“Ndërtimi i një strehimoreje për personat LGBTQI+ në Kosovë do të ishte një hap historik drejt fuqizimit, pavarësisht dhe sigurisë së këtij komuniteti. Një vend i sigurt do t’u mundësonte atyre të largohen nga dhuna dhe abuzimi, të jetojnë të lirë dhe të jenë vetvetja pa frikë. Kjo strehimore do të ishte një garanci themelore për dinjitetin dhe sigurinë e personave LGBTQI+ në Kosovë” – P 001.

Intervistat me personat LGBTQI+

KATEGORIA TEMATIKE: NEVOJA PËR STREHIMORE

Personat LGBTQI+ listuan disa prej nevojave të cilat kërkojnë që të funksionalizohet strehimorja, ku përmenden se personat përballen me diskriminim, mungesë të mbështetjes dhe pranimi nga familja e shoqëria, ku këto rrethana bëjnë që këta persona të jetojnë në situata jo të qeta dhe të trajtohen keq në ambientet ku jetojnë apo të përjashtohen plotësisht. Të intervistuarit kanë potencuar se krijimi i strehimores do mundësonte që personat LGBTQI+ të mos tolerojnë mjedise të pashëndetshme dhe të rrezikshme për ta, por se ofrimi i shërbimit të tillë do siguronte që këta persona të kenë mirëqenie më të mirë dhe të jenë pjesë e rretheve ku ndjehen se po përkasin dhe po respektohen me dinjitet.

“Strehimoret për personat queer në Kosovë janë të nevojshme dhe të rëndësishme sepse diskriminimi në Kosovë kundër personave LGBTQI+ është i shpeshtë kështuqë mos pranimi i familjes, papunësia mundet me i shëndërru personat në të pastrehë” – P 004.

Të gjeturat nga intervistat me personat LGBTQI+ tregojnë se personat e përceptojnë se arsyeja pse nuk është realizuar ende strehimorja ka të bëjë me paragjykimet që shoqëria në përgjithësi ka për personat LGBTQI+ dhe se mungesa e përkushtimit të plotë nga institucionet për ta realizuar projektin. Potencohet se çështjet queer ende trajtohen si çështje tabu ku rrjedhimisht personat në pushtet ende nuk e shohin me prioritet apo seriozitet. Në raport me funksionalizimin e qendrës, theksohet se strehimorja duhet të krijohet sa më shpejt por se në proces të vendimarrjes duhet të angazhohen edhe vetë personat nga komuniteti në mënyrë që të avokojnë sa më shumë mbi nevojat dhe se strehimorja të krijohet në raport me to, kjo mendohet se do të ndikonte masën e shoqërisë të ndëgjojë dhe kuptojë vuajtjet e nevojat e personave LGBTQI+, ku rrjedhimisht strehimoren ta konsiderojnë si prioritet.

“Si çdo komunitet minoritet në Kosovë, këta persona anashkalohen me ose pa qëllim, nuk merren seriozisht deri sa nuk ndodh diqka tragjike” – P 005.

KATEGORIA TEMATIKE: NDIKIMI I STREHIMORES NË JETËN E PERSONAVE LGBTQI+

Personat LGBTQI+ raportojnë se realizimi i strehimores do kishte shumë përfitime për komunitetin pasi që fillimisht do ju garantohej siguri dhe strehimorja do i mundësonte mbrojtjen e tyre nga dhuna, diskriminimi apo përjashtimi. Poashtu theksohet se përmes shërbimeve, strehimorja do ishte poashtu një vend i këshillimit profesional, rehabilitimit psiko-social dhe një fillim i ri i një jetese.

“Siguri!! Jep siguri edhe për personat që nuk kanë nevojë për strehimore për veten, por ideja që është një vend ku mund të shkojë do lehtësoj jetën e shumë njerëzve” – P 007.

MODELI PRAKTIKËS SË MIRË PËR STREHIMORE

Në Evropë ekzistojnë disa modele të mira të strehimoreve për personat LGBTQI+ kukëto strehimore inkorporojnë disa elemente si strehimi i sigurt, mbështetja psiko-sociale dhe bashkëpunimi (përkrahja) ndërinstitutionale mundësojnë që të ofrohet mbrojtje sociale dhe shërbime që fuqizojnë personat LGBTQI+. Disa strehimore të tilla në Evropë si CASA+ në Itali, Le Refuge në Francë, LGBT Assylum Support në Holandë ilustrojnë rëndësinë e ofrimit të shërbimeve holistike përveç strehimit bazë. Pavarësisht se shembujt e lartëshënuar, në një pjesë merren dhe me azilkërkuesit LGBTQI+ si dhe sigurimin e strehimit për ta, në këtë punim do merren disa karakteristika që këto qendra posedojnë për të elaboruar modelin e praktikave më të mira. Këto qendra, përveç strehimit kanë disa shërbime të specializuara përmes të cilave përfitojnë personat e strehuar, ndër këto shërbime janë këshillimi psikologjik, mbështetja nga rrethi social, ofrimi i shërbimeve bazuar në qasjen e informuar nga trauma, asistencë ligjore, kujdesi shëndetësor, programe për arsim (kurse), programe për punësim dhe riintegrim në komunitet. Pra, përmes shërbimeve, ideja nuk lidhet me mbijetesën afatshkurtër por fuqizimin në aspekt afatgjatë duke u siguruar personave kushtet e nevojshme për riintegrim social.

Sa i përket mënyrës së financimit, qendrat me qëndrueshmëri mbështeten prej fondeve publike, komunale si dhe donacioneve nga organizatat. Poashtu, përveç financave, bashkëpunimi ndër institucional është elementi tjetër i qëndrueshmërisë ku qendrat janë pjesë e rrethit të integruar institucional ku përfshihen ministritë, konunat, organet e rendit dhe drejtësisë, gjyqësori, shërbimet sociale etl. Ky bashkëpunim mundëson që rasti të ndjeket në të gjitha institucionet e nevojshme dhe se referimi e komunikimi përmbajtësor mes institucioneve të ndihmojë fuqizimin e personave. Pra, këto modele tregojnë që strehimoret më efektive dhe të suksesshme duhet të bazohen në profesionalizëm, shërbime gjithëpërfshirëse dhe bashkëpunim ndërinstitutional.

Konkludimi

Nga analiza e të gjeturave me me përfaqësues të organizatave dhe personat LGBTQI+ del se ekziston një nevojë emergjente për krijimin e strehimores, kjo vie si pasoja e dhunës në ambiente familjare, përjashtimi nga familja, mungesa e mbështetjes institucionale dhe mos ofrimi i strehës në ndonjë formë tjetër. Krijimi i strehimores shihet si hap i domosdoshëm në ofrimin e sigurisë, përkuqdesjes dhe shërbimeve psiko-sociale dhe fuqizimit të personave LGBTQI+ duke i ofruar atyre mundësinë për të jetuar në pavarësi, larg ambienteve dhe situatave të pashëndetshme e të rrezikshme si dhe për të jetuar me dinjitet. Përfaqësuesit e organizatave/aktivistët tregojnë se strehimorja duhet të jetë projekt me shërbime më holistike ku do të përfshiheshin shërbime të interguara si ndihma psiko-sociale, ligjore, trajnime, kurse, ndihmë në punësim dhe programe të zhvillimit personal e profesional.

Pavarësisht se projekti për strehimoren ka filluar që nga viti 2020, procesi ka hasur në disa sfida administrative të lidhura më specifikisht me mos buxhetimin dhe mungesën e trajtimit të çështjes me prioritet institucional. Ky bashkëpunim ndër-institucional dhe me organizatat mbetet ndër kushtet e domosdoshme për realizimin e projektit të strehimores. Në anën tjetër personat LGBTQI+ e shohin se kjo heshtje dhe mos veprim institucional në raport me këtë çështje tregon pozicionin e institucioneve që nuk njohin dhe nuk trajtojnë sfidat, të drejtat dhe nevojat e personave LGBTQI+. Të gjeturat tregojnë se praktika e strehimores nuk ka ndryshuar, por ka ndodhur një përmisim që Komuna e Prishtinës ka ndarë dy njësi banesore si zgjidhje e përkohshme. Të gjeturat tregojnë se strehimorja do të sillte shumë përfitime për personat LGBTQI+, sepse do të shërbente si një formë fuqizimi dhe sigurie për ta. Njohja e faktit se ekziston një vend i sigurt ku mund të drejtohen në raste përjashtimi apo dhune do t'i ndihmonte personat të mos qëndrojnë në situata që rëndojnë mirëqenien e tyre, poashtu do krijohej ndjenja e përkatësisë në grup ku pranohen dhe mbështeten. Përveç kësaj, personat që do të përfitonin ndihmën e nevojshme do t'i mundësonte personat të rimëkëmbeshin pas përvojave traumatike. Në këtë kontekst, strehimorja është një veprim që tregon përkushtimin shtetëror për respektimin e të drejtave të njeriut dhe vlerave të drejtësisë, dinjitetit e barazisë, ndërsa për personat LGBTQI+ është një realitet që përmison jetesën dhe mirëqenien.

Referencat

Badgett, M. V. L., Waaldijk, K., & Rodgers, Y. van der M. (2019). The relationship between LGBT inclusion and economic development: Macro-level evidence. *World Development*, 120, 1–14. <https://doi.org/10.1016/j.worlddev.2019.03.011>

Bender, K., Yang, J., Ferguson, K., & Thompson, S. (2015). Experiences and needs of homeless youth with a history of foster care. *Children and Youth Services Review*, 55, 222–231. <https://doi.org/10.1016/j.childyouth.2015.06.007>

Case, A. D. , & Hunter, C. D. (2012). Counterspaces: A unit of analysis for understanding the role of settings in marginalized individuals' adaptive responses to oppression. *American Journal of Community Psychology*, 50, 257–270. 10.1007/s10464-012-9497-7

DeChants, J. P., Green, A. E., Price, M. N., & Davis, C. K. (2021). Homelessness and housing instability among LGBTQ youth (Homelessness Report). West Hollywood, CA: The Trevor Project. Retrieved from <https://www.thetrevorproject.org/wp-content/uploads/2022/02/Trevor-Project-Homelessness-Report.pdf>

Dylberizm. (2024, January 24). Personat LGBTIQ+ në Kosovë kanë nevojë urgjente për një strehimore! Retrieved from https://www.dylberizm.com/2024/01/24/s_lgbtq/

Ecker, J. (2016). Queer, young, and homeless: A review of the literature. *Child & Youth Services*, 37(4), 325–361.

Edidin, J. P., Ganim, Z., Hunter, S. J., & Karnik, N. S. (2012). The mental and physical health of homeless youth: a literature review. *Child psychiatry and human development*, 43(3), 354–375. <https://doi.org/10.1007/s10578-011-0270-1>

Gattis, M. N. (2013). An ecological systems comparison between homeless sexual minority youths and homeless heterosexual youths. *Journal of Social Service Research*, 39(1), 38–49.

Gattis, M. N., & Larson, A. (2017). Perceived microaggressions and mental health in a sample of black youths experiencing homelessness. *Social Work Research*, 41(1), 7–17.

Harper, G. W. , & Schneider, M. (2003). Oppression and discrimination among lesbian, gay, bisexual, and transgendered people and communities: A challenge for community psychology. *American Journal of Community Psychology*, 31(3–4), 243–252. 10.1023/a:1023906620085

Kattari, S.K., Barman-Adhikari, A., DeChants, J., & Rice, E. (2017). Social networks and sexual risk factor differences between cisgender heterosexual and cisgender LGBTQ homeless youths. *Journal of Gay & Lesbian Social Services*, 29(2), 182–200.

Llullaku, N., Selimi, R., Roest, J., & Van Der Helm, G. H. P. (2024). Kosovo sexual minorities: A mental health crisis. *Journal of Gay & Lesbian Mental Health*, 28(4), 549–567. <https://doi.org/10.1080/19359705.2023.2213217>

Maccio, E. M. , & Ferguson, K. M. (2016). Services to LGBTQ runaway and homeless youth: Gaps and recommendations. *Children and Youth Services Review*, 63, 47–57. 10.1016/j.childyouth.2016.02.008

Maton, K. I. (2008). Empowering community settings: Agents of individual development, community betterment, and positive social change. *American Journal of Community Psychology*, 41(1-2), 4-21. 10.1007/s10464-007-9148-6

Moskowitz, A., Stein, J.A., & Lightfoot, M. (2012). The mediating roles of stress and maladaptive behaviors on self-harm and suicide attempts among runaway and homeless youth. *Journal of Youth and Adolescence*, 41(7), 1015-1027. <https://doi.org/10.1007/s10964-012-9793-4>

Saewyc, E., Mounsey, B., Tourand, J., Brunanski, D., Kirk, D., McNeil-Seymour, J., Shaughnessy, K., Tsuruda, S., & Clark, N. (2017). Homeless & street-involved indigenous LGBTQ2S youth in British Columbia: Intersectionality. In A. Abramovich, & J. Shelton J. (Eds.), *Where am I going to go? Intersectional approaches to ending LGBTQ2S youth homelessness in Canada and the US* (pp. 13-40). Toronto, Ontario, CA: Canadian Observatory on Homelessness.

Slesnick, N. , Glassman, M. , Garren, R. , Toviessi, P. , Bantchevska, D. , & Dashora, P. (2008). How to open and sustain a drop-in center for homeless youth. *Children and Youth Services Review*, 30(7), 727. 10.1016/J.CHILDYOUTH.2007.12.004

Thompson, S. J. , Bender, K. , Windsor, L. , Cook, M. S. , & Williams, T. (2010). Homeless youth: Characteristics, contributing factors, and service options. *Journal of Human Behavior in the Social Environment*, 20(2), 193-217. 10.1080/10911350903269831

Wilson, B. D., Choi, S. K., Harper, G., & Lightfoot, M. (2020). *Homelessness Among LGBT Adults in the US*. Los Angeles: UCLA Williams. Institute.

